Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-723
Datë: 30.07.2026

Në mbështetje të nenit 4 dhe 23 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës nr. 03/L-189, nenit 6 dhe 16 të Ligjit për Kualifikimet Kombëtare nr. 03/L-060, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë nr. 35/2014, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e IV-t e mbajtur me datë 30.07.2026 nxjerrë këtë:

VENDIM

1. Aprovohet ankesa për rishqyrtim e Akademia për Teknologji dhe Dizajn "ATD", e paraqitur kundër Vendimit të Këshillit Drejtues të AKK-së, nr. 01/472, datë 29.05.2026.

2. Ndryshohet pika 1.1 e Vendimit nr. 01/472, datë 29.05.2026, vetëm në pjesën që ka të bëjë me realizimin e cikleve të trajnimit, dhe e njëjta riformulohet si vijon:

> 2.1. Automekanik, Niveli IV i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D), me 11 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e Aftësimit Profesional për një vit kalendarik në 2 grupe, me maksimum 20 kandidatë/nxënës për grup, përkatësisht 40 kandidatë/nxënës në total për një vit. Brenda këtyre kapaciteteve, institucioni mund të organizojë dhe realizojë deri në 8 cikle të trajnimit gjatë një viti kalendarik.

3. Të gjitha dispozitat tjera të Vendimit nr. 01/472, datë 29.05.2026, mbesin të pandryshuara.

4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Akademia për Teknologji dhe Dizajn "ATD" ka paraqitur, brenda afatit të përcaktuar me nenin 20 të Udhëzimit Administrativ nr. 35/2014, ankesë për rishqyrtim të Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 01/472, datë 29.05.2026, duke kontestuar pjesën e vendimit që ka të bëjë me kufizimin e realizimit të trajnimeve.
Gjatë shqyrtimit të ankesës, Këshilli Drejtues kërkoi sqarime shtesë nga paneli i ekspertëve që kishte realizuar vlerësimin.

Nga sqarimet e panelit të ekspertëve rezultoi se në raportin përfundimtar ka ndodhur një gabim teknik në formulimin e rekomandimit, pasi paneli kishte vlerësuar se institucioni disponon kapacitetet për organizimin e deri në tetë (8) cikleve të trajnimit gjatë një viti kalendarik, ndërsa në dispozitivin e vendimit nuk ishte pasqyruar kjo e dhënë.

Paneli konfirmoi se numri i grupeve dhe numri maksimal i kandidatëve për grup mbeten të pandryshuara, ndërsa korrigjimi lidhet vetëm me saktësimin e numrit maksimal të cikleve që institucioni mund të realizojë gjatë një viti kalendarik.

Duke u bazuar në sqarimet e panelit të ekspertëve, dokumentacionin e lëndës dhe kompetencat e tij ligjore, Këshilli Drejtues vlerësoi se ankesa është e bazuar dhe vendosi ta aprovojë atë, duke ndryshuar pjesërisht pikën 1.1 të Vendimit nr. 01/472, datë 29.05.2026, ndërsa pjesët tjera të vendimit mbesin në fuqi.

Vendimi u dërgohet:

1. Akademia për Teknologji dhe Dizajn "ATD"
2. Arkivit të AKK.

Prof. Dr. Besim Mustafa

Kryetar KD së AKK